

# *Rasti i **KRIPORES** së Ulqinit*

***KRIPA (NUK) ËSHTË JETË***



Emri i publikimit: **Rasti i Kripores së Ulqinit: KRIPA (NUK) ËSHTË JETË**

Botues: **OJQ “Ul info”**, Mëhalla e Re 80, 85360 Ulqin

e-mail: [info@ul-info.com](mailto:info@ul-info.com), [mcanka@t-com.me](mailto:mcanka@t-com.me)

Për botuesin: **Mustafa Canka**

Redaktor: **Mustafa Canka**

Skudra autoriale:

**Suzana Ganiq**

**Admir Gjoni**

**Iliriana Markashi**

**Mustafa Canka**

**Sejdo Ismajli**

Përpunimi grafik: **Foto Bruno**

Fotografitë: **Ul-info**

Ulqin, prill 2021

Ky studim është krijuar në kuadër të projektit “Kriporja dhe K1 – Lak në fytin e Komunës së Ulqinit”, të cilin e financon QAQ bazuar në kontratën nr. 3/2020 - MPP/2019/413-757, e i cili është pjesë e projektit “Përkrahja e mediave vendore – tregimet nga dora e parë! Përkrahja e gazetarisë hulumtuese dhe edukimit mediatik në nivelin vendor në Mal të Zi”, të cilin e realizojnë B film Montenegro, Qendra për Arsimimin Qytetarë (QAQ), Fondacionin Share dhe Instituti për Edukimin Ekonomik dhe Financiar (IEEF), e me përkrahjen e Delegacionit të Bashkimit Europian në Mal të Zi dhe Ministrisë së Administratës Publike, Shoqërisë Dixhitale dhe Mediave.

Përmbajtja e këtij studimi është përgjegjësi vetëm e OJQ “Ul info” dhe në asnjë mënyrë jo domosdoshmërisht pasqyron qëndrimet e BE-së, Ministrisë së Administratës Publike, Shoqërisë Dixhitale dhe Mediave apo të QAQ-së, B film-it, Fondacionit Share dhe IEEF-së.

## Fjala hyrëse

Plotë shtatë vjet (1927 - 1934) iu deshën ndërtuesve të Kripores që në prapavijën e Plazhit të Madh, në zonën moçalore, të ndërtojnë fabrikën e kristaleve të kripës. Ishte koha e një entuziazmi të madh, sepse besohej që ky projekt mund të rilindë këtë qytezë të lënë pas dore, e cila atëherë kishte 3.500 banorë.

Vërtet: për nevojat e Kripores në qytet u sollën uji dhe energjia elektrike, disa qindra njerëz u punësuan në këtë ndërmarrje të madhe, ndërsa në mesin e viteve 30' nisi lulëzimi ekonomik i Ulqinit. Në vitin 1935 u ndërtua hoteli “Republika” në Ranë, tre vite më vonë hoteli “Jadran”, ndërsa në vitin 1939 hoteli “Ko-op”, i cili më vonë u quajt “Galeb”, hoteli më modern në tërë bregdetin e Adriatikut, u ndërtuan rrugët dhe infrastruktura tjetër e nevojshme e qytetit.

Kriporja u shndërrua në simbol të Ulqinit modern. Quhej nënë dhe ushqyese dhe së bashku me Ndërmarrjen Hoteleriko – Turistike “Riviera e Ulqinit” ishte krenaria e vendasve për dekada me radhë.

Për inicimin e një projekti të tillë nevojitej vizioni, dija dhe ndihma e madhe e shtetit. Sepse, për ta shndërruar detin në kripë, me ndihmën e erës dhe diellit, e Kriporen në kompani të suksesshme, nevojitet mjaftë kripë edhe në kokë. Formula ishte e thjeshtë: natyra, zelli dhe durimi. Ky kombinim i dashurisë gjithmonë jep rezultate të mira.

Pra, fillimi i punës së Kripores në vitin 1934 ishte pika kthyese në historinë e vonshme të Ulqinit. Ajo, që është akoma më e rëndësishme, solli mënyrën e re të të menduarit. Aty kanë punuar kuadrot më të mirë, të cilët erdhën nga i tërë vendi. Vetëm nga Dalmacia ishin rreth 20 inxhinier.

Kriporja kishte bibliotekën për punëtorët e saj, pastaj edhe projektorin për kinema. Arkitekti i Kripores, drejtori dhe inxhinieri Ante Koludroviq, ishte kryetari i Aero – Moto klubit i cili në vitin 1938, para 83 vjetëve pra, organizoi Aero – mitingun në Ulqin!

E sa është vetëm numri i Ulqinakëve të cilët u shkolluan gjatë tetë dekadash, sa prej tyre fituan bursa të larta, punën e sigurt, pagën e mirë dhe prestigjin në shoqëri?!

Unë Kriporen e njoftova në vitin 1987, si maturant i Gjimnazit të Ulqinit. Ne, meshkujt nga klasa, punuam për të grumbulluar paratë e nevojshme për ekskursion. Atëherë u binda se çka është Kriporja: gjigant në kornizat e Jugosllavisë së madhe.

Kur ai shtet filloi të rrënohet, kur Kriporja u shndërrua në ndërmarrje partiake, kur ajo pa mëshirë është shtyrë drejtë falimentimit, kur duhej të bëhej holding në vdekje, ku s'ka as grumbullim të kripës, as punëtorë, as koncesion për ujë të detit, kur u shkatërruan pompat, u ndërpre rryma, u shiten pajisjet, unë nuk e humba shpresën. E dija që rrënjët e kësaj kompani janë të thella.

Edhe pse tani i ngjanë Vukovarit nga koha e luftës, Kriporja prapë do të ringjallet si feniksi. Tash të gjithë e dimë se ajo është vlerë turistike, ekonomike, ekologjike dhe kulturore e Ulqinit dhe e tërë vendit. Europianet me të drejtë thonë – edhe e tyrja.

Tani është momenti i duhur që përsëri të mobilizohet ky komunitet i vogël i bindur se ripërtëritja e Kripores do të thotë fillimin e epokës së re në historinë e këtij qyteti mijëvjeçar.

**Mustafa Canka**

## Kronika e zezë e një privatizimi

- Në vitin 2004 “Eurofondi” bëhet pronar shumicë i Kripores “Bajo Sekuliq” në falimentim për 800 mijë euro
- Në vitin 2005 nis procesi i “falimentimit të programuar”
- Ndërkohë, Eurofondi merr kredi duke e vendosur në hipotekë pronën e Kripores dhe duke emetuar aksione
- Banka vendos në hipotekë miliona metra katror të tokës në Kripore
- Në vitin 2011 prapë iniciohet procedura e falimentimit
- Nga viti 2012 u organizuan 14 tentativa të dështuara të shitjes së pronës së Kripores, edhe pse është çështje kontestuese nëse Eurofondi ka të drejtën e shfrytëzimit apo të drejtën e pronësisë
- Në vitin 2013 është organizuar grumbullimi i fundit i kripës
- Në vitin 2014 të gjithë punëtorët e Kripores u përjashtuan nga puna
- Nga viti 2015 Kriporen e administron Ndërmarrja Publike “Parqet Nacionale të Malit të Zi” me qëllim mbrojtjen e biodiversitetit
- Vazhdon procesi i falimentimit. Shteti ka 0% të kapitalit në Kripore, pohojnë nga Eurofondi.
- Me shitjen për hekur të vagonëve, shinave, transportuesit, makinës për paketim, dy eskavatorëve,... gjatë vitit 2020 përfundoi procesi i shkatërrimit të pronës së tundshme dhe të patundshme në Kripore. Në gusht të këtij viti u soll vendimi për likuidimin e Eurofondit.

## Nga simboli deri tek baltina

Gjatë vitit 2020, Mali i Zi importoi kripë në vlerë prej 1,24 milion euro. Vendi ynë është i vetmi në Mesdhe i cili e importon këtë artikull të rëndësishëm strategjik.

Sipas të dhënave të fundit të Monstat<sup>1</sup>, vitin e kaluar më së shumti kripë u importua nga Gjermania 193 mijë euro, ndërsa një mijë më pak nga Egjipti. Më tutje, nga Austria importohet kripë në vlerë prej 146 mijë euro, nga Serbia 1.000 më pak, ndërsa nga Shqipëria 132 mijë euro.

U bënë plotë tetë vjet që në Kripore nuk prodhohen kristalet e kripës. Gjatë kësaj periudhe Mali i Zi importoi kripë në vlerë prej mbi tetë milion euro.

“Kripore e Ulqinit është foleja e vetme e flamingove<sup>2</sup> në bregun lindor të Adriatikut dhe është tejet e rëndësishme për turizmin. Turistët nga Europa shkojnë deri në Afrikë për t’i vëzhguar, e ne i kemi këtu para hundës”, thotë ornitologu **Darko Saveliq.**



<sup>1</sup> [http://monstat.org/cg/publikacije\\_page.php?id=1873](http://monstat.org/cg/publikacije_page.php?id=1873)

<sup>2</sup> Flamingo ose lejlekë krahëkuq

Ai paralajmëroi se në qoftë se nuk vazhdohet prodhimi i kripës në një afat të afërt, ekziston mundësia që këto shpendë mos të vijnë më në Ulqin, sepse ato janë shpendë të habitateve të njelmëta dhe s'e durojnë ujin e ëmbël.

Këto janë vetëm dy tregues preciz të raportit shkurtpamës dhe dëmtues ndaj fabrikës më të vjetër në Ulqin dhe hapësirës unike me sipërfaqe prej 15,2 milion metër katror.

Edhe pse çdo gjë është falas (uji, dielli, era), prodhimi i *arit të bardh* të Ulqinit, siç pohonin edhe nga adresat shtetërore – është i paqëndrueshëm!? Madje disa planifikues qeveritarë thoshnin se prodhimi në Kripore e shkatërron ambientin!? Edhe pse për dekada të tëra ajo ishte shembulli më i mirë i zhvillimit të qëndrueshëm në bregun lindor të Adriatikut dhe model shembullor i raportit të njeriut me natyrës. Prandaj nga simboli i Ulqinit dhe i tërë shtetit, ajo u shndërrua në baltinë e ujërave të ëmbla.

„Kriporja e Ulqinit, e cila u shkatërrua në mënyrë sistematike, sot ngjanë sikur trupat e pushtesve brutal marshuan mes për mes saj. Ajo është shkatërruar si pas ekspeditave luftarake dhe dikush duhet të mbajë përgjegjësi për këtë gjendje“, tha pas vizitës së parë në këtë zonë kryetarja e Këshillit Drejtues të Ndërmarrjes Publike Parqet Nacionale të Malit të Zi **Marina Joçiq**<sup>3</sup>.

Përndryshe, Kriporja është krijuar si ekosistem artificial, i dirigjuar nga njeriu. Dhe vetëm ai është në gjendje ta çrregullojë. Në dëm të vetin dhe në dëm të botës bimore dhe kafshore. Këtë e tregon edhe rasti me, siç e quan ekologu nga Ulqini **Xhelal Hoxhiq**, motrën e Kripores, kanalën e Port Milenës. Kjo hapësirë, dikur vend shumë i madh i peshkut në Mesdhe, është bërë një „bombë ekologjike“ e vërtetë, gjersa fotografitë e kanalit me shtëpiza atraktive të peshkatarëve (kalimerat) para të cilave gjenden rrjetet e peshkatarëve vazhdojnë të përhapen nëpër botë.

<sup>3</sup> Kjo kompani shtetërore prej vitit 2015, me vendim të Qeverisë së Malit të Zi, e administron Kriporen e Ulqinit

## Frika nga përsëritja e rastit “K 1”

Ministri i Ekologjisë, Planifikimit Hapësinor dhe Urbanizmit **Ratko Mitroviq** deklaroi se nevojitet zgjidhja e marrëdhënieve pronësore – juridike në Kripore, për të ditur se kush është pronar. “A do të kemi një partneritet publiko – privat, këtë do ta shohim dhe vendosim në nivel Qeverie”, tha ai gjatë vizitës në Kripore në dhjetor të vitit të kaluar duke shtuar se kjo është rruga e vetme e drejtë që Kriporja të fillojë të funksionojë në njëfarë mase.

“Do të bëhet studimi dhe do ta gjejmë zgjidhjen më të mirë. Qëllimi është që ta valorizojmë Kriporen si resurs turistik dhe ekologjik”, tha Mitroviq.

Nga Komuna e Ulqinit pohuan se e kanë hartuar Planin e Administrimit, të cilin ia dorëzuan Qeverisë. Siç thonë, nëse nuk zgjidhet çështja e pronësisë në Kripore, kjo vetëqeverisje vendore s’do ta marrë përsipër obligimin e administrimit të kësaj ndërmarrje. Jozyrtarisht, funksionarët vendor kanë theksuar se në asnjë mënyrë nuk dëshirojnë që eventualisht tu përsëritet rasti “K1”<sup>4</sup>, në të cilin Komuna e Ulqinit u gjykua 36 vjet dhe në fund ishte e obliguar që në vitin 2019 t’i paguajë kompanisë “Rekreators” rreth 6,5 milion euro.



Tash dhjetë vjet pritet vendimi se a është paguar çmimi i tregut për Kriporen e Ulqinit. Për këtë arsye Komisioni për Privatizim dhe Projekte Kapitale formoi komisionin e veçantë profesional i cili Qeverisë duhet t’i dorëzojë ekspertizën se a

<sup>4</sup> Rasti i quajtur sipas pushimores “Kosova 1”, në Plazhin e Madh, e cila u prish në fillimvitet 80’



ishin rreth 800 mijë euro, sa pagoi Fondi për Investime të Përbashkëta “Eurofond”<sup>5</sup> në bursë, çmim real për blerjen e Kripores në fund të vitit 2004.

Dy vjet më herët, vlera e kësaj ndërmarrje ishte 110,3 milion marka të atëhershme gjermane, që është ekuivalent me përafërsisht 55 milion euro.

Kjo është interesante për faktin se çmimi i fundit në tenderin e 14 për shitjen e kësaj ndërmarrje<sup>6</sup>, të cilin në fund të nëntorit të vitit 2018 e shpalli administruesi i falimentit **Zharko Ostojiq** ishte 149 milion euro. Disa vite më herët, në tenderin e parë, çmimi ishte 257,98 milion euro. Pra, mbi 300 herë më shumë se çmimi i blerjes!?

Këto shpallje publike shërbyen vetëm për të blerë kohë gjersa të përfundojë puna për shkatërrimin përfundimtarë të Kripores. Gjatë një dhjetëvjeçari të plotë kjo punë është kryer në mënyrë goditëse, sistematike dhe me plan, që dëshmohet me mënyrën e privatizimit, falimentimit, ndalimin e prodhimit dhe dëbimin e punëtorëve.



<sup>5</sup> Ky fond është i lidhur pronësisht me manjatin kontrovers **Veselin Baroviq**.

<sup>6</sup> Kjo është bërë edhe pse në fillim të vitin 2016 administrata e falimentit kumtoi se nuk do t'i shpallë më ankandet publike për shitjen e fabrikës dhe 15 milion metër katror tokë gjersa mos të rregullohen marrëdhëniet pronësore në mes shtetit dhe ndërmarrjes.

## Krim me vulë shtetërore

Synimin e Eurofond-it, që për pak para ta blejnë tokën e Kripores e për sa më shumë ta shesin dhe/ose ajo të valorizohet, me të gjitha fuqitë e kanë përkrahur pushtetet malazeze. Ky është njëri nga shembujt më tipik të tranzicionit dëmtues malazez, të nëpërkëmbjes së mundit të tre gjeneratave dhe luftës së krisur kundër natyrës. Krim me vulë shtetërore.

Sepse, prej fillimit të viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar Kriporen fillimisht e ka shpupurishur partia e atëhershme në pushtet, e cila e konsideronte atë ndërmarrje të veten. Kripa për një periudhë të gjatë kohore ishte produkt monopolist në konfederatën e Serbisë dhe Malit të Zi dhe burim i pasurisë për shumë individë të afërt me regjimin malazez. Kur filloi shfrenimi me patundshmëri, Kriporja e shtrydhur u la në duart e manjatëve.

Agonia e vërtet e kompanisë dhe e punëtorëve të saj nisi kur Kriporen e morri Eurofondi, ndërsa shteti dhe institucionet e tija e përkrahen Baroviçin që ta përmbushë qëllimin e tij.

Për t'i dhënë hov projekteve të planifikuara në Kripore, në “oborrin e saj”, në Port Milenë, me para nga buxheti i shtetit është ndërtuar ura madhështore me vlerë 14 milion euro. Sepse, sipas planit të menduar të pronarëve të Kripores, kjo zonë do të lidhej me kanal me Bunën dhe Port Milenën, dhe në Kripore do të mund të hynin anijet dhe jahtet. Është planifikuar që kjo urë të ketë mekanizmin, përkatësisht të ketë mundësinë të hapet.

Ky nuk ishte fundi i bashkëpjesëmarrjes së shtetit në planet e pronarit shumicë të Kripores. Me heqjen e koncesionit për prodhimin e kripës, Qeveria e Malit të Zi tentoi të shtyjë marrëveshjet eventuale për shitjen e tokës dhe ndërtimin e kompleksit turistik në këtë zonë.

“Bëhet fjalë për hajninë e shekullit dhe ndodhinë klasike të tranzicionit ku me blerjen e fabrikës ajo shkatërrohet, ndërsa me ridedikimin e tokës rritet çmimi

i saj në treg”, vlerësoi deputeti i atëhershëm në Kuvendin e Malit të Zi **Dritan Abazović**.<sup>7</sup>

Në vitin 2014 Kripores iu ndërpre furnizimi me energji elektrike për shkak të borxhit ndaj kompanisë shtetërore Elektroekonomia e Malit të Zi me vlerë vetëm 20.800 euro!<sup>8</sup>



Vetëm në këtë kontekst kuptohet arsyeja se përse autorët e Planit Hapësinor të Malit të Zi, në muzgun e procesit të sjelljes së këtij dokumenti në vitin 2008, larg syve të opinionit, kanë paraparë mundësinë e ndërtimit të vendbanimit turistik në këtë zonë, ndërsa Qeveria dhe Parlamenti shtetëror më vonë vetëm e miratuan.

Mirëpo, në vitin 2012 Kuvendi i Komunës së Ulqinit miratoi vendimin sipas të cilit Kripores së Ulqinit i kthehet statusi i zonës së mbrojtur, gjersa tre vjet më vonë Gjykata Kushtetuese e shpalli jokushtetues këtë vendim!?! Gjykata kushtetuese theksoi në arsyetimin se Parlamenti shtetëror i ka tejkaluar kompetencat e veta, përkatësisht ka përjashtuar Qeverinë nga i tërë procesi, e cila, siç thanë ato, sipas ligjit e propozon Planin Hapësinor, ndërsa Kuvendi e miraton.

<sup>7</sup> <http://mne.ul-info.com/abazovic-solana-je-pokusaj-pljacke-stoljeca/>

<sup>8</sup> Skenar i ngjashëm është përdorur edhe në rastin e Ndërmarrjes Hotelerike – Turistike “Riviera e Ulqinit”, e cila në vitin 2004 u çua në faliment për shkak të borxhit ndaj EEMZ-së me vlerë 231 mijë euro.

## I merren kompetencat vetëqeverisjes vendore

Në korrik të vitit 2009, Qeveria e Malit të Zi morri nga vetëqeverisja vendore detyrën e hartimit të Planit Hapësinor – Urbanistik të Ulqinit (PHU). Të gjitha komunat në Mal të Zi e kanë punuar vet këtë dokument planifikues, sepse kjo është kryekëput kompetencë e tyre.

Mirëpo, për ta shfrytëzuar, pra, hapësirën e mrekullueshme të Ulqinit sipas qejfeve të Podgoricës zyrtare dhe manjateve të afërt me te, Qeveria me *zemërgjerësi* vendosi ta hartojë dhe paguajë këtë plan me rëndësi të jashtëzakonshme për të ardhmen e Ulqinit. Plani ishte që, për rreth 800 mijë euro, ta vizatojë Plazhin e Madh, Kriporen, Valdanosin dhe Pyllin e Pishave ashtu siç dëshiron ajo.

Mirëpo, skenari i betonimit të kësaj hapësire dështoi, pik së pari për arsye të njohjes së rëndësisë së Kripores nga ana e Komisionit Evropian, Parlamentit Evropian, Këshillit të Evropës, ambasadave të shteteve perëndimore në Podgoricë, si dhe shoqërive civile vendase dhe ndërkombëtare.

Meqenëse në Ulqin, edhe pse i mposhtur politikisht, nuk ekzistonte gatishmëria që të pranohen hapur planet e manjatëve në Kripore, u kalua në variantin rezervë, hartimin e Planit Hapësinor me Dedikim të Veçantë për Zonën Bregdetare. “Drafti i këtij dokumenti parasheh mbrojtjen e këtij lokaliteti dhe ndërtimin e përmbajtjeve turistike komplementare (vështrimin e florës dhe faunës dhe resorti ekologjik) në një pjesë të vogël të Kripores, në të cilën edhe tani ekziston zona ndërtimore me sipërfaqe rreth gjashtë hektarë (nga gjithsej 1.500 ha sa përfshinë e tërë Kriporja), si dhe s’bëhet fjalë për çfarëdo kapacitetesh turistike ose të tjera në kuadër të lokalitetit të Kripores e të cilat përmenden në opinion”, u njoftua asokohe nga Ministria e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Turizmit.

Pra, dëshirat për betonimin e Kripores u reduktuan në *vetëm* 2,35 për qind të sipërfaqes së saj të përgjithshme dhe në *vetëm* 1.500 shtretër.

Njëkohësisht, shumë u vonua iniciativa për regjistrimin e Kripores në Listën

Ramsar të zonave të mbrojtura moçalore me rëndësi ndërkombëtare, edhe pse Kriporja plotësonte gjashtë nga nëntë kushtet për regjistrimin në këtë listë. E për tu regjistruar, nevojitej plotësimi i vetëm një kushti.

Mund të shërbente vetëm si simbol i shtetit – jashtë shtetit. Qeveria e Malit të Zi në Bienalen e 15 të arkitekturës në Venedik në vitin 2016 morri pjesë me projektin *Kriporja e Ulqinit*. “Kriporja është një nga ato vendet fantastike të cilët me ekzistencën e vet vërtetojnë simbiozën e njeriut dhe natyrës dhe rikujtojnë se sa i rëndësishëm është insistimi në këtë lidhje”, tha komisarja e prezantimit të Malit të Zi, arkitektja **Dijana Vuçiniq** duke thënë se “Kriporja është tërësisht krijesë e njeriut e cila posedon biodiversitetin unik të florës dhe faunës në nivel ndërkombëtarë dhe ka rolin kyç në lëvizjet globale të shpendëve”.



## Punëtorët bëhen tepriçë

Numri i punëtorëve është zvogëluar vazhdimisht: nga 450 (1995) deri në 70 (2014). Arsyeja më e shpeshtë të rrallimit të fuqisë punëtore ishin pagat shumë të ulëta, si dhe atmosfera e keqe në kolektivë, ndërsa problem i veçantë ishte mungesa e kuadrove profesionale (në veçanti e theksuar prej vitit 2002 deri në vitin 2014).

“Kripa është prodhuar çdo vit (përveç në vitin 2002), mirëpo menaxhmenti ishte gjithnjë e më i uritur dhe gjithnjë e më pak mjete ndante për të punësuarit, e gjithnjë e më shumë për nevojat e veta (personale). Po ashtu, menaxhmenti ka ndryshuar, mirëpo parimi i punës mbeti i njëjtë. Ishte e trishtueshme të shihen grumbujt e kripës nga të cilët s’keni dobi. S’kishin mundësi të ndryshoni asgjë, sepse menaxhmenti ishte i afërt me strukturat politike në pushtet, të cilët ishin edhe anëtarë të Këshillit të Drejtorëve të obliguar për kontrollin e punës së menaxhmentit. Shumëkush është habitur se si administrimi i papërgjegjshëm afatgjatë, më saktësisht vjedhja e rëndë e punëtorëve dhe e shtetit, s’mund ta dëmtojë Kriporen”, foli për nevojat e këtij publikimi ish drejtuesi i financave në Kripore **Veselin – Sasha Mitroviq**.

Sipas fjalëve të tija, Kriporja e pësoi goditjen më të rëndë në vitin 2010 kur, siç pohon, u vodhën 20 mijë tonë kripë dhe një milion euro nga arka. “Atëherë u vu pika në punën e Kripores, e punëtorët u plaçkiten. Më vonë u qitën në rrugë dhe askush nuk mbajti përgjegjësi për këtë gjë. Edhe sot e kësaj dite kur i pyesni ato njerëz nga Gjykata Ekonomike thonë se të gjitha i kanë bërë sipas ligjit, prandaj ne punëtorët i quajmë – mafia e falimentimit”, shtoi Mitroviq.



## Në vitin 1939 në Kripore punonin 800 punëtorë

Më 22 gusht të vitit 1939 kadetët e anijes shkollore “Vila Velebita” e vizituan Ulqinin gjatë udhëtimit studimor nëpër Adriatik.<sup>9</sup>

Përveç monumenteve tjera të qytetit, ato vizituan edhe Kriporen e Ulqinit. Në ditarin e anijes ato shënuan se në Kripore, në sipërfaqe prej 8,5 milion metër katror, ka mbi 100 basene të kripës dhe prodhohet mbi 1.500 vagonë kripë, ose mbi dhjetë për qind të konsumit të përgjithshëm të kripës në Mbretërinë e atëhershme të Jugosllavisë.

“Në këtë ndërmarrje punojnë gjithsej 800 punëtorë”, i thanë drejtuesit e Kripores kadetëve të “Vila Velebitit”.



<sup>9</sup> <http://ul-info.com/ne-kripore-ne-vitin-1939-kane-punuar-800-punetore/>

## Ambasadoret shpëtuan Kriporen

“Njerëzve jo rrallë i nevojitet që dikush tjetër t’iu tregojë se çfarë kanë në oborrin e tyre. Kriporja është hyjnore, margaritar natyror, madje diçka e mbinatyreshme”, thoshte ish ambasadorja e Polonisë në Mal të Zi **Grazhina Sikorska**.

Ajo tha se qytetarët e Malit të Zi kanë mundësi që për çdo ditë ta shijojnë atë për të cilën njerëzit anembanë botës ndajnë para të mëdha. “Në vend se të shkoni në Floridë të vëzhgoni flamengot, ejani në Kripore”, thoshte Sikorska në vitin 2015.



Për shpëtimin e biodiversitetit unik të Kripores është angazhuar edhe më fuqishëm ambasadorja e Republikës Federative të Gjermanisë në Podgoricë **Gudrun Elizabet Shtajnaker**, e cila komunikonte pothuajse për çdo ditë me zyrtarët e Komunës së Ulqinit dhe me funksionarët e Qeverisë së Malit të Zi. Shumë aktive rreth kësaj çështje ishte edhe një diplomate nga vendet e Bashkimit Europian, ambasadorja e Francës **Veronik Brimo**.



Ky “trekëndësh vajmarik i ambasadoreve” pohoi se Kriporja e Ulqinit është e rëndësishme në nivel evropian si habitat i shpendëve dhe lokalitet me shumë vlerë, që paraprakisht u vërtetua edhe me vendimet e Komisionit Evropian dhe Këshillit të Europës.

Pikërisht presioni i fuqishëm nga Brukseli dhe Strasburgu, si dhe dedikimi i përcaktuar me Planin Hapësinor – Urbanistik të Ulqinit, parandaluan në momentin e fundit skenarin e shndërrimit të Kripores në tokë ndërtimore ku do të mbinin komplekset turistike dhe fushat e golfit.

Në fillim të vitit 2014 u krijua përshtypja se ky operacion i përgatitur me kujdes do të përfundojë me sukses. Mirëpo, Kriporja s’është më brend dhe bukuri vetëm e Ulqinit dhe Malit të Zi, por edhe e tërë Europës. Këtë e kuptuan me vonesë zyrtarët malazez, prandaj tentuan padëshirë ta ndihmojnë disi pronarin e Kripores.

“A është zgjidhja që të bëhet segmentimi i kësaj prone? Të ndahet një pjesë, të urbanizohet, të ndryshohet plani, dhe atë për një dedikim, që mbi këtë bazë të shlyhen borxhet ndaj punëtorëve dhe kreditorëve në afatin sa më të shkurtër, e me atë segmentim të mos rrezikohet procesi i prodhimit të ardhshëm të kripës”, mendonte me zë në Parlamentin shtetëror ministri i atëhershëm i financave **Radoje Zhugiq**.

Asistonte edhe administruesi i falimentimit **Ognjen Jovoviq** duke thënë se “ekziston mundësia reale që një pjesë e Kripores të shfrytëzohet në këtë mënyrë”.

Të vetëdijshëm se kjo do të nënkuptonte “dritën e gjelbër” për hyrjen e eskavatorëve në këtë hapësirë të mrekullueshme, deputetët e opozitës të ndihmuar nga anëtarja e koalicionit qeverisës, Partia Socialdemokrate, me ngulm i refuzuan mendimet e tilla. Prandaj, e tërë çështja duhej të kthehej në fillim. Skenari sipas të cilit në prapavijën e Plazhit të Madh duhet të mbijë “Dubai i ri” u shkri si kripa në ujë.

Për të fshehur tentativa e dështuar e vrasjes së Kripores, u hap Shpallja Publike për Bashkëpunimin Ekonomiko – Teknik.

## Kriporja është perlë dhe mrekulli e natyrës e cila të lë pa frymë

Nga Qendra për Mbrojtjen dhe Hulumtimin e Shpendëve pyetën publikisht: ku t' i çoni mysafirët që udhëtuan tërë botën, e në dispozicion keni vetëm një ditë dhe dëshironi që vendin tuaj ta kujtojnë si diçka të veçantë?

Përgjigja e tyre ishte: “Çojini në Kriporen e Ulqinit dhe në Valdanos! Mijëra shpend të cilët pushojnë dhe dimërojnë në Kripore shkaktojnë ndjesinë e paqes e cila s' mund të blihet në tjetër vend. Pastaj vizita në Valdanos, shëtitja mes për mes ullinjve të moçëm prej të cilëve disa janë të vjetër mbi një mijë vjet. Vendet e tilla magjike janë të fundit të llojit të vet në Europë”.



Për ta treguar edhe fizikisht brengosjen dhe dëshirën që Kriporja të mbrohet, është bërë rregull që çdo fundjavë dikush nga anëtarët e korit diplomatik të vizitojë Ulqinin dhe të mahnet me bukurit e saja.

“Moti i bukur dhe mrekullitë e natyrës të cilët të lënë pa frymë na rikujtuan sesa e rëndësishme është të ruajmë dhe mbrojmë çdo margaritar të mjedisit jetësor”, tha ish ambasadorja amerikane në Podgoricë Margaret Uehara.

Ish shefi i Delegacionit të Bashkimit European në Mal të Zi ambasadori **Mitja Drobnic** tha se nga aspekti i turizmit, Kriporja e Ulqinit është perlë të cilën do ta ruante çdokush po ta kishte.

“Shpresoj se shteti është i vetëdijshëm për këtë. Nëse Kriporja nuk ruhet, nuk do të ruhet as imazhi ornitologjik i Europës. Mos e bëni këtë gjë”, thoshte diplomati sloven.

## Aeroporti i shpendëve në Kripore

Bashkë me fushat e kripës, në Kripore gjithmonë ishin me dhjeta mijëra shpend. Kjo hapësirë e mrekullueshme moçalore është vendi ideal, baza e tyre gjatë udhëtimit nga veriu i Europës dhe Siberia në drejtim të Afrikës, dhe anasjelltas. Kjo “lagunë kulturore” është habitat për 265 lloje shpendësh, prej të cilëve 138 janë specie të rralla dhe të mbrojtura në botë, për ç arsye Kriporja u rendit në zonën e rëndësishme ndërkombëtare për shpend (IBA).

Drejtoresha ekzekutive e Qendër për Mbrojtjen dhe Hulumtimin e Shpendëve<sup>1</sup> **Jovana Janjusheviq** deklaroi se Kriporja e Ulqinit është 15 herë më e rëndësishme për shpendët për nga numri i tyre, sesa është aeroporti më frekuent “Heathrow” në Londër për njerëzit.



“Prandaj e kemi brenduar Kriporen si aeroport të shpendëve dhe si një nga vendet më të rëndësishme në korridorin shtegtar në Mesdhe”, tha ajo.

Sipas fjalëve të saja, 15 llojet e rrezikuara të shpendëve të cilët janë në kripore shënojnë një për qind të popullatës biogeografike në tërë botën! “Po ta krahasojmë këtë me numrin e banorëve në planetin tokë këto do të ishin qytete milionike, sepse ne as s’mund ta imagjinojmë se ekzistojnë megapolisët me 70 milion banorë”, shtoi ajo.<sup>2</sup>

Sot vëzhgimi i shpendëve në botë është biznes më fitimprurës sesa turizmi nautik. Gjatë pranverës Kriporja është stacioni i nisjes për më shumë se 40 mijë zogj shtegtarë në ditë. Habitat i ngjashëm nuk ekziston në asnjë vend të rajonit.

<sup>1</sup> Centra za zaštitu i proučavanje ptica (CZIP)

<sup>2</sup> <http://mne.ul-info.com/janjusevic-solana-15-puta-vaznija-od-najfrekventnijeg-aerodroma/>

## Kriporja në fokusin europian

Pikërisht presioni shumëvjeçar nga jashtë rezultoi me mbrojtjen e Kripores në nivelin shtetëror dhe ndërkombëtarë. Që nga viti 2015, Komisioni Europian në secilin progres raport ka theksuar rregullisht dhe veçmas problemet e Kripores dhe ka kërkuar zgjidhjen e tyre. Me përkrahjen e BE-së në vitin 2017 u hartua Studimi i Mbrojtjes së Kripores së Ulqinit, ndërsa në krye të projektit ishte drejtori i Parkut të Natyrës “Kriporja Seçovle” dhe ornitologu i njohur nga Sllovenia **Andrej Sovinc**.

Sipas fjalëve të tija, mbijetesa e habitatit dhe specieve pothuajse në tërësi varet nga mirëmbajtja e regjimit të ujit, i cili për vite të tëra është shfrytëzuar për prodhimin tradicional të kripës, dhe thekson rëndësinë e ornitofaunës e cila e vendos Kriporen e Ulqinit në majën e lokaliteteve më të rëndësishme për folezimin, shtegtimin dhe dimërimin e shpendëve në të ashtuquajturin Korridorin migrues të Adriatikut.



Sovinc shprehu bindjen se në këtë dokument u propozua “modeli optimal i administrimit të zonës në mënyrë që të sigurohen vlerat e saja ekologjike dhe ekonomike”.<sup>10</sup>

<sup>10</sup> <https://mrt.gov.me/ministarstvo/177134/Saopstenje-Odrzan-treci-sastanak-Upravnog-odbora-projekta-Finalizacija-studije-zastite-Ulcinjske-solane.html?alphabet=lat>

Dy vite më vonë Komisioni Evropian përsëriti kërkesën për ndërmarrjen e aktiviteteve të vendosura dhe urgjente, të nevojshme për administrimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e zonës së Kripores, dhe para së gjithash sqarimin e çështjes së pronësisë.

Më 24 qershor të vitit 2019, pas miratimit të vendimit në seancën e Parlamentit vendor, Kriporja u shpallë zonë e mbrojtur – Park i Natyrës. Në korrik të vitit 2019 Ministria e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Turizmit e kandidoi Kriporen për regjistrimin në Listën Ramsar. Dy muaj më vonë, ajo u bë pjesë e regjistrit të moçaleve me rëndësi botërore.

Qasja ndaj Kripores ishte kushti kyç që Mali i Zi të hap kapitullin 27 në negociatat me Bashkimin Evropian, e i cili ka të bëjë me mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike.

Në vend që “shteti i parë ekologjik në botë” ta hap këtë kapitull të parin dhe ta mbyllë menjëherë, ai edhe sot e kësaj dite duhet të dëshmojë se është i përkushtuar ndaj obligimeve që rrjedhin nga Kushtetuta e tij.

Institucionet Europiane kanë vlerësuar se Kriporja është prova më e mirë e lakmusit për ta provuar këtë gjë, më saktësisht ajo është shndërruar në simbol të ndodhive në Mal të Zi.

### **Punë sa të duash, e prokuroria e ngathët**

“Ka indicie që falimentimi i prodhimtarisë së Kripores është shkaktuar artificialisht. Sipas informatave që unë kam, vazhdon hetimi i prokurorisë”, tha ish ambasadorja gjermane në Podgoricë Gudrun Shtajnaker.

Pas tentativës së fundit për shitje në mars të vitit 2019, organizatat joqeveritare MANS, Qendra për Mbrojtjen dhe Hulumtimin e Shpendëve, Shoqata “Martin Scheider – Jacoby Association” dhe Shoqata Malazeze e Ekologëve dorëzuan një

muaj më vonë padinë penale kundër administruesit të falimentimit të Kripores **Zharko Ostojqi**, Mbrojtësit të Interasave Pronësoro – Juridike dhe personave përgjegjës në Drejtorinë për Pronë dhe Drejtorinë për Patundshmëri për shkak të dyshimit se keqpërdoren pozitën.



Ato pohonin se Ostojiqi shpalli thirrjen për shitjen e tokës shtetërore në të cilën Kriporja kishte të drejtën e shfrytëzimit vetëm gjersa ka prodhuar kripë, por edhe që organet shtetërore nuk e kanë regjistruar pronën e cila është bërë pjesë e masës së falimentimit. Ato kanë konsideruar se kjo ndërmarrje e Ulqinit asnjëherë nuk ishte pronare e tokës dhe se në procesin e privatizimit nuk e ka paguar kompensimin e tregut. E vetmja bazë mbi të cilën kishin të drejtën e pronësisë ishte eksploatimi i kripës i cili s’bëhet më, thanë nga këto organizata.

Ostojiqi tha se Kriporja ka të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm në ndërtesë dhe tokë dhe se kjo s’është pengesë për shitjen.

Në vitin 2016 MANS-i dorëzoi paditë penale në Prokurorinë Speciale Shtetërore për shkak të marrjes së kredisë ku për hipotekë u shfrytëzua toka e Kripores!?

Padia në fillim të vitit të kaluar është refuzuar sepse, siç thanë nga Prokuroria, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale<sup>11</sup>.

<sup>11</sup> Parashkrimi absolut i ndjekjes penale ndodh kur lënda për atë ndjekje penale konsiderohet e vjetruar.

“Bëhet fjalë për disa kredi me vlerë të përgjithshme 5,2 milion euro, të cilat janë marrë në Bankën Komerciale Malazeze<sup>12</sup> dhe Bankën e Parë<sup>13</sup> ku si kolateral u vendos toka e cila nuk ishte në pronësi të Kripores, përkatësisht ishte dhe vazhdon të jetë pronësi e shtetit. Kriporja, përkatësisht pronari i atëhershëm Eurofondi, kishte vetëm të drejtën e shfrytëzimit prandaj në asnjë rast kjo pronë nuk mund të shfrytëzohej si kolateral për sigurimin e kredisë”, tha drejtori i Qendrës Hulumtuese të MANS-it **Dejan Milovac**.

Mirëpo, pas disa muajsh, Prokuroria e Lartë Shtetërore e rihapi këtë lëndë.<sup>14</sup>

Për shkatërrimin kriminal dhe paligjshmërinë në Kripore askush nuk mbajti përgjegjësi.

### **Plani i administrimit gati, mirëpo...**

Shpenzimet e ndërmarrjes së ardhshme, e cila do të administrojë Parkun e Natyrës “Kriporja e Ulqinit” do të jenë disa milionëshe, ndërsa Komuna e Ulqinit, e cila është themeluese e ndërmarrjes, parashikon se vetëqeverisja vendore për gjashtë vjet, nga buxheti i saj, do të shpenzojë 1,5 milion euro për punën e kompanisë. Është planifikuar që 960.000 euro të sigurohen nga Qeveria e Malit të Zi, gjersa të hyrat vetanake të ndërmarrjes gjatë periudhës trevjeçare do të jenë vetëm 273 mijë euro. Të ardhurat nga shitja e kripës priten në vitin e katërt të punës dhe atë me vlerë 91.000 euro, sa do të ishin edhe në dy vitet e ardhshme. Gjatë vitit të parë nga arka e Komunës do të shpenzohen rreth 170.000 euro, pastaj 370.000 dhe 345.000 në dy vitet e ardhshme. Pas tre viteve të para, Komuna do të paguajë nga 200.000 euro në tre vitet e ardhshme.

Këto shifra përmenden në Draftin e Planit për Administrimin e Parkut të Natyrës “Kriporja e Ulqinit” i cili akoma nuk u shqyrtua nga këshilltarët e

<sup>12</sup> Në gjuhën malazeze – Crnogorska komercijalna banka

<sup>13</sup> Në gjuhën malazeze – Prva banka

<sup>14</sup><http://www.mans.co.me/wp-content/uploads/2020/05/Solana-Bajo-Sekulic%CC%81-i-prodaja-imovine-studija-sluc%CC%8Caja-autoput.pdf>

parlamentit vendor. Plani përfundoi së hartuari në qershor të vitit 2020 dhe vlerësohet si kyç për revitalizimin e Kripores dhe administrimin e ardhshëm të kësaj hapësire. Për përpilimin e tij punuan funksionarët e Komunës së Ulqinit, Ministrisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Turizmit, Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, sektorit civil, si dhe ish punëtorët e Kripores.



Administrata e falimentimit dha mendimin negativ për Planin e Administrimit të Kripores, të cilin ia dërgoi Komuna e Ulqinit. Ky dokument iu dërgua edhe Gjykatës Ekonomike dhe Qeverisë së Malit të Zi, përkatësisht Ministrisë përgjegjëse.

Plani ishte që vetëqeverisja vendore të marrë përsipër administrimin e Kripores më 24 gusht të vitit të kaluar, mirëpo hoqi dorë sepse, siç u njoftua, s'u krijuan parakushtet juridike që të hyhet në këtë punë, prandaj Parqet Nacionale të Malit të Zi dhe administrata e falimentimit kanë nënshkruar Aneksin e Kontratës për qiramarrjen e kësaj ndërmarrje, i cili do të jetë i vlefshëm deri në gusht të këtij viti.

Prandaj, në muajt e ardhshëm pritet që Plani i Administrimit të rishikohet, sepse me buxhetin e Komunës së Ulqinit për vitin 2021, për punën e shoqërisë së ardhshme ekonomike, e cila do të administrojë Parkun e Natyrës, janë paraparë 150 mijë euro.



## Eurofondi paralajmëron Komunën e Ulqinit

“Komuna e Ulqinit u nis në drejtim të katastrofës meqë synon të administrojë masën e falimentimit të Kripores së Ulqinit”, është njoftuar në fund të qershorit nga Eurofondi.<sup>15</sup>

Siç thanë, në vendimin e vetëqeverisjes vendore për themelimin e ndërmarrjes, e cila do të administrojë Kriporen, heshtet se kemi të bëjmë me masën e falimentimit. “Në historikun e gjyqësorit nuk ekziston rasti ku mundësohet administrimi i masës së falimentimit nga palët e treta, sepse ligji përcakton që Gjykata Ekonomike, përmes administratës së falimentimit, administron dhe disponon me masën e falimentimit në interes të kreditorëve”, thanë nga ky fond duke shtuar se për këtë fakt folën edhe administratori i falimentimit, por edhe aksionarët pakicë të Kripores.

Me vendimin sipas të cilit Komuna e Ulqinit e shpalli Kriporen Park të Natyrës administrimi i është besuar Parqeve Nacionale të Malit të Zi, të cilët, siç theksojnë nga Eurofondi, janë qiramarrës klasik të Kripores



<sup>15</sup> <https://www.feral.bar/post/1090>

në bazë të kontratës me Gjykatën Ekonomike e cila është e vetmja që mund të administrojë masën e falimentimit.

Nga Eurofondi vlerësuan se e vetmja zgjidhje ligjore është që organi kompetent më në fund të zgjidh çështjen e pronësisë, për të cilën, siç pohojnë ato, administrata hesht nga viti 2011.

Mirëpo, shpejt pas këtij paralajmërimi drejtuar Komunës së Ulqinit dhe vetëm një ditë mbas mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare në Mal të Zi më 30 gusht të vitit 2020, u soll vendimi për likuidimin e Fondit të Hapur Investues “Eurofond” Podgoricë.<sup>16</sup> Për likuiduesin e Fondi është caktuar **Boisha Shotra**.

Nga Qeveria e Malit të Zi, e cila është formuar në fillim të dhjetorit të vitit 2020, kanë njoftuar se Kriporja së shpejti do të hiqet nga rendi i ditës.

Mirëpo, çështja e pronësisë është vetëm parakusht për ripërtëritjen e kësaj hapësire, përkatësisht shndërrimin e një historie të gjatë, të rëndë dhe të zorshme në histori suksesi, të mundësive dhe shpresave të mëdha për njerëzit, shpendët dhe natyrën.


### Vazhdimi i shkatërrimit

Derisa pritet (është pritur) zgjidhja përfundimtare e çështjeve të hapura, përfundoi procesi i shkatërrimit të gjërave të tundshme dhe të patundshme në Kripore.

Në gusht të vitit 2020 për hekur u shitën vagonët, shinat, transportuesi, pastaj edhe makina për paketim, dy eskavatorë, pjesa e mbetur e automjeteve, shtyllat e rrymës prej metali...

Ish punëtorët pohojnë se makina për paketim, e cila është paguar 1,2 milion

<sup>16</sup> Në arsyetimin e këtij vendimi thuhet se “pavarësisht përpjekjeve dhe një sërë aktiviteteve të Menaxhmentit, asnjë bankë nuk ka shprehur gatishmërinë ta nënshkruajë kontratën për kryerjen e punëve depozitare, përkatësisht të jetë depozitar i Eurofondit”



euro, ishte e re dhe e papërdorur!? U shit kompanisë nga Nikshiqi “Qendra për Riciklim” për shumën 30 herë më të vogël!?

Administruesi i falimentimit në Kripore **Zharko Ostojiq** tha se çdo gjë që është shitur, është bërë në pajtim me shpalljen e publikuar paraprakisht.

“Vijesti” ka shkruar se nga Kriporja janë marr rreth 600 tonë hekur të vjetër.

Momentalisht punojnë vetëm dy pompa, në Gjerana dhe në stacionin 16, gjersa pompa në stacionin 31 është jashtë funksionit.

Përndryshe, një nga episodet më trishtuese në dy dekadat e tmerrshme në Kripore ishte zhdukja e mini eskavatorit, të cilin fondacioni “Euronatur” ia dhuroi Kripores në vitin 2003. Kjo makinë me vlerë 45.000 euro është paraparë të shfrytëzohet për mirëmbajtjen e pendëve dhe habitateve për shpend.

Mirëpo, gjashtë vite më vonë ajo është marr nga Kriporja dhe çuar në drejtim të paditur, ndërsa përfundoi në një servis në Budvë e shkatërruar tërësisht.<sup>17</sup>

Përkundër padive penale dhe kontesteve ndërkombëtare, plotë dhjetë vjet opinioni s’ka informata për fatin e këtij mini eskavatori.

<sup>17</sup> <https://www.vijesti.me/vijesti/drustvo/486043/bager-zavrsio-u-starom-gvozdju>

## Nis rimëkëmbja

“Kripa e detit nga Kriporja e Ulqinit bëhet nga uji më i pastër i Adriatikut dhe prodhohet nga dielli dhe era. Përbënë 97 për qind të klorur-natriumit, ndërsa pjesa e mbetur janë magnezi, zinku, bromi... të gjithë ato suplemente të cilët i blejmë në farmaci. Kjo kripë është shëruese. Sllovenia e brendoi kripën si prodhim, edhe pse kripa e tyre, nga uji i papastër i Adriatikut, ka cilësi përgjysmë më të dobët”, thotë ekologu **Darko Saveliq**, i cili tash dy vite merret me hulumtimin dhe mbrojtjen e Kripores.

Kolegu i tij më i vjetër, Ulqinaku **Xhelal Hoxhiq**, konsideron se Kriporja duhet të jetë atraksion turistik, ekologjik dhe zhvillimor i Ulqinit. “Vazhdimi i prodhimit të kripës është kusht për mbijetesën e natyrës në këtë hapësirë, për qëndrimin e shpendëve dhe kultivimin e peshkut dhe gaforreve cilësore në laguna. Përveç këtyre, nëse ka prodhim atëherë do të ketë edhe peloid cilësorë (baltë shëruese), e cila ekziston edhe tani në sasi të pakufizuara, ndërsa disa hotelier e importojnë me çmim 8 euro për kilogram”, shton ai.



Edhe ish drejtuesi i financave në Kripore **Veselin – Sasha Mitroviq** pohon se Kriporja pa problem mund të punojë në mënyrë rentabile.

“Në një vit të mirë Kriporja prodhonte mbi 25.000 tonelata kripë, madje

edhe më shumë (2003 – 33.000 tonelata). Mali i Zi për ushqim përdorë rreth 3.000 tonelata, për mirëmbajtjen e rrugëve në periudhën dimërore rreth 5.000 tonelata të tjera me tendencë rënie për shkak të dimrave gjithnjë e më të butë. Rrjedhimisht, Kriporja e Ulqinit pa problem mund të kënaqë të gjitha nevojat e Malit të Zi për kripë dhe pjesa më e madhe mbetet për eksport (mbi 70%), kështu që vendi mund të kursejë sasi të konsiderueshme nga importi i kripës (në vitin 2020 është importuar kripa me vlerë 1,24 milion euro), si dhe të fitojë shuma të konsiderueshme nga eksporti në tregjet e huaja, përkatësisht të zbusë bilancin e pakënaqshëm të tregtisë së jashtme”, vlerësoi ai.<sup>18</sup>

Gjatë tërë kësaj periudhe ishin një sërë kompanish të huaja të gatshme për qiramarrjen e Kripores, ose të marrin pjesë në partneritetin publiko – privat i cili do të bënte rindërtimin e tërësishëm të saj dhe do të inicioje prodhimin e kristaleve të kripës, si dhe të ruante, mbronte dhe avanconte biodiversitetin e zonës. Mirëpo, moszgjidhja e statusit pronësor ishte pengesa kryesore për realizimin e investimeve në Kripore.

“Ekzistojnë një sërë organizatash ndërkombëtare dhe banka zhvillimore të cilat mund të investojnë në zhvillimin e Kripores, në dobi të Ulqinit dhe Malit të Zi. Mirëpo, askush s’do të investojë në projektin ku nuk dihet pronësia”, tha ambasadorja Shtajnaker.

Përkundër faktit se, siç thotë, ndonjë investitor i ri duhet të fillojë nga zeroja, ministri i ekologjisë, planifikimit hapësinor dhe urbanizimit **Ratko Mitroviq** është optimist. “Neve nuk na duhen investime të mëdha që të kemi prodhimin e kripës për dy apo dy vjet e gjysmë. Për Qeverinë këto s’janë mjete të mëdha. Nevojiten dy eskavatorë, 30 punëtorë dhe pak mot të bukur që të kryhen punët dhe t’i kthejmë basenet në nivelin e para dhjetë vjetësh”, theksoi ai.

Duke konstatuar se Mali i Zi është i vetmi vend në Mesdhe të cilit s’i paguhet prodhimi i kripës, Saveliq vlerëson se vendimi a duhet të aktivohet Kriporja apo jo është tërësisht politik.

<sup>18</sup> Studimi i mbrojtjes cakton vlerën e përgjithshme ekonomike në Kripore në nivel vjetor 5,84 milion euro, të cilën e bazon në vlerësimin e dobive nga një sërë shërbime

Mirëpo, ky proces ka nisur siç duket. Me përkrahjen e Qendrës për Mbrojtjen dhe Hulumtimin e Shpendëve pak kohë më parë nisi blerja e pajisjeve të reja për punën e Kripores.

“Fillimisht, bëhet fjalë për blerjen e pompës për stacionin numër 31, i cili është, praktikisht, “zemra e Kripores”, si dhe të një eskavatori të ri. Pa këto pajisje nuk mund të nis puna e kompanisë”, thanë ish punëtorët e kompanisë nga Ulqini duke shprehur bindjen se me blerjen e këtyre pajisjeve dhe me vendimet e organeve shtetërore, së shpejti mund të fillojë funksionimi i Kripores.



“Shumë është me rëndësi që ne ta presim këtë pranverë dhe verë në basenet e Kripores. Nëse hyjmë në vjeshtë dhe dimër, atëherë praktikisht e kemi humbur edhe një vit”, thanë ato.

Ulqinakët e moçëm kanë thënë se “pa bukë mundet, por pa kripë jo”. Mirëpo, po ashtu është e nevojshme puna e madhe dhe e vyeshme, si dhe pak – kripë në kokë.

Njëjtë siç Ulqinit i nevojitet shumëllojshmëria e aktiviteteve ekonomike, e jo

varësia nga turizmi, i cila i sjell tre të katërtat e të ardhurave direkte dhe indirekte qytetarëve të kësaj komune. Prova më e mirë e kësaj janë luftërat, tërmetet dhe epidemitë të cilat kanë ndodhur në këtë zonë në gjysmëshekullin e fundit.

“Kur tufa e pelikanëve kalon mbi kryeqytetin e kripës të Adriatikut lindor, ajo brohorit njëjtë sikur njerëzit: kripa është jetë – jeta është kripë!”, thotë ornitologu nga Sllovenia dhe njohësi i shkëlqyer i Kripores **Borut Shtrumberger**.

Pra, ndërtimi i Kripores në vitin 1934 ishte pika kthyesë në historinë e vonshme të Ulqinit. Pas saj u ndërtuan hotelet, infrastruktura, institucionet e qytetit. Filloi zhvillimi i gjithanshëm i qytetit. Për këtë arsye Kriporja gjithmonë është konsideruar dhe përjetuar si nënë dhe ushqyese e Ulqinit dhe e qytetarëve të tij.

Prandaj, nëse jo në vitin 2021 atëherë të paktën në vitin 2022, pra plotë 88 vite pas fillimit të punës së saj, pse mos të jetë njësoj?



## Literatura e përzgjedhur

Agencija za zaštitu životne sredine, *Studija zaštite područja „Ulcinjaska Solana“*, Podgorica, 2015

Canka Mustafa, *Paraqitje interkulturore – Ulqin dhe Tivar*, OJQ “Ul info”, 2020  
*Elaborat: Solana “Bajo Sekulić” AD Ulcinj, Analiza postojëćeg stanja i mogućnosti rentabilnog poslovanja*, 2015.

*Istorijski leksikon*, Daily Press – Vijesti, Podgorica, 2006.

Karamanaga Ismet, *Ulqini florini, Portrete, in memoriam*, Ulqin, 2020.

Koludrović Anto, Franić Mladen, *Sol i morske solane*, Zagreb, 1954

MANS, *Studija slučaja: Propast solane „Bajo Sekulić“ zbog interesa domaćih tajkuna* <http://www.mans.co.me/wp-content/uploads/studijeslucajeva/Solana.pdf>

MANS, *Zaštita solane i pokušaj prodaje državne imovine* <http://www.mans.co.me/wp-content/uploads/2020/05/Solana-Bajo-Sekulic%CC%81-i-prodaja-imovine-studija-sluc%CC%8Caja-autoput.pdf>

Matvejević Predrag, *Mediterranski brevijar*, CID, Podgorica, 2003.

Tryezë e rrumbullakët, *Drejtimet dhe prioritet e zhvillimit të prodhimit dhe përpunimit të kripës së detit*, Ulqin, 1998

Panković Živan, *O morskoj solani u Ulcinju*, Monopolski kalendar za 1940, Narodna biblioteka Srbije

Radović Vaso, *Solana Ulcinj*, Ulcinj, 2008



*Plan upravljanja parkom prirode „Ulcinjska solana“* (Nacrt) [http://www.ul-gov.me/upload/document/20200707\\_plan\\_upravljanja\\_park\\_prirode\\_solana\\_sa\\_p.pdf](http://www.ul-gov.me/upload/document/20200707_plan_upravljanja_park_prirode_solana_sa_p.pdf)

*Prostorni plan Crne Gore 2020*, Montenegroinženjering”, Podgorica, IAUS Institut za arhitekturu i urbanizam Srbije, Beograd, Urbanistički inštitut Republike Slovenije, Ljubljana, 2008.

Saveljić Darko, Vizi Ondrej, Dubak Nela, *Ptice Crne Gore i njihova značajna staništa*, “Vijesti”, Podgorica, 2006

Schwarz, U., Sackl, P., *Land structure, flooding and breeding bird survey in the Salina Ulcinj 2016*. Euronatur report, 2017

Sovinc, A., Tome, D., Hosek, M. *Studija zaštite za područje Ulcinjske Solane*, 2017 [http://www.ul-gov.me/upload/document/nacrt\\_studije\\_zastite\\_za\\_podrucje\\_ulcinjske\\_solane.pdf](http://www.ul-gov.me/upload/document/nacrt_studije_zastite_za_podrucje_ulcinjske_solane.pdf)

*Strategija održivog razvoja područja Solane “Bajo Sekulić“ u Ulcinju*, Eurofond AD, Podgorica, 2015. [http://www.eurofond.me/system/redactor\\_assets/documents/202/Strategija\\_odrzivog\\_razvoja\\_Solane.pdf](http://www.eurofond.me/system/redactor_assets/documents/202/Strategija_odrzivog_razvoja_Solane.pdf)

Stumberger, B., Sackl, P., Saveljic, D., Schneider-Jacoby, M., *Management plan for the conservation and sustainable use of the natural values of the privately owned Nature park “Solana Ulcinj”*, Montenegro, Joannea-Zoologie 10, 2008

Stanisic, M., Zekovic, B., Soskic, M., *Ulcinj Salina Ecosystem Services Assessment Report*, Podgorica, 2020

*Ulcinjska Solana – Analiza pravnih i institucionalnih izazova u procesu EU integracija i zatvaranja poglavlja 27*, CZIP, Podgorica, 2020 (<https://czip.me/2021/02/01/ulcinjska-solana-analiza-pravnih-i-institucionalnih-izazova-u-procesu-eu-integracija-i-zatvaranja-poglavlja-27/>)

Ushaku Ruzhdi, *Ulqini në përmasa kërkimi dhe frymëzimi*, Fondacioni “Lika”, Ulqin, 2010

## Aktet juridike

Baza elektronike e kadastrës së patundshmërive <https://ekatastar.me>

Vendimi për shpalljen e Parkut të Natyrës “Kriporja e Ulqinit” (“Fl. zyrtare e Malit të Zi” – dispozitat komunale, nr. 30/19)

Ligji për Pronën Shtetërore (“Fl. zyrtare e Malit të Zi”, nr. 21/09 dhe 40/11)

Ligji për Matjet Shtetërore dhe Kadastrën e Patundshmërive (“Fl. zyrtare e RMZ”, nr. 29/07 dhe “Fl. zyrtare e MZ”, nr. 32/11, 40/11 – ligji tjetër, 43/15, 37/17 – dispozitat tjera, 37/17-I dhe 17/18)

Ligji për Paaftësinë Paguese të Shoqërive Ekonomike (“Fl. zyrtare e RMZ”, nr. 6/02, 1/06, 2/07 dhe “Fl. zyrtare e MZ” nr. 62/08)

Ligji për Koncesione („Fl. zyrtare e MZ”, nr. 8/09)

Ligji për Privatizimin e Ekonomisë („Fl. zyrtare e RMZ“, nr. 23/96, 6/99,59/00,42/04)


Ligji për Falimentimin (“Fl. zyrtare e MZ”, nr. 1/11)

Ligji për Marrëdhëniet pronësoro - juridike (“Fl. zyrtare e MZ”, nr. 19/09)

Ligji për Mbrojtjen e Natyrës („Fl. zyrtare e MZ“ nr. 54/16 dhe 18/19)



# SOLANA I KI OMČE ZA VRATOM OPŠTINE ULCINJ



Ovaj projekat finansira  
Evropska unija

Projekat „Solana i K1 - omče za vratom opštine Ulcinj“ realizuje NVO „UL info“, a podržan je kroz program „Podrška lokalnim medjima – priče iz prve ruke“ koji sprovodi Centar za građansko obrazovanje (CGO), B film, SHARE fondacija, Institut za poslovnu i finansijsku pismenost. Program finansira Evropska unija, a kofinansira Ministarstvo javne uprave, digitalnog društva i medija Vlade Crne Gore.



Crna Gora  
Ministarstvo javne uprave,  
digitalnog društva i medija